

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e njëmbëdhjetë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **12.12.2019** (e enjte) duke filluar në orën **11:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Shqyritimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2019 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2020;
3. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;
4. Rregullimi i kanalizimit në Pasjak, banorit të fshatit Hasan Matoshi;
5. Hapja e pusit me ujë të pishëm për tri familje në lagjen e re Pasjak;
6. Të ndryshme;


Me: 09.12.2019
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 15.11.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Zymer Zymeri, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Shefja e ZKKK Jasmina Denic, UNMIKU-ut, përfaqësuesit i OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raportim mbi realizimin e projekteve për vitin 2019;
3. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;
4. Propozim plani Komunal për ri integrimin e qendrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022;
5. Propozim plani Akcional për të zhvendosur dhe Kthim të qëndrueshëm;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Aprovohet rendi i ditës nga të gjithë antarët prezent të komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja tha: pasi që muajin e kaluar nuk ka qenë procesverbali edhe në gjuhën serbe shkojm me aprovimin e procesverbalit të mbledhjes së tetë.

Aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent procesverbali i mbledhjes së tetë.

Kryesuesja tha: a keni ndonjë vërejtje nga procesverbali i mbledhjes së kaluar apo shkojm me aprovim.

Pasi nuk pat vërejtje procesverbali u aprovua njëzëri nga të gjithë antarët prezent të komitetit.

Pika e dytë: Raportim mbi realizimin e projekteve për vitin 2019;

Kryesuesja tha: nuk është askush që të raportoj për këtë pikë, por këtë pikë e shtyem për mbledhjen e ardhshme.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: para se ta futni këtë pikë në rend dite a keni kërkuar prej Drejtoris së caktuar që të raportoj?

Kryesuesja tha: ftesa është dërguar dhe mu nuk më kanë njoftuar asgjë nese vin apo jo.

Abdyl Gashi tha: mendoj se paraprakisht duhet të kontaktohet me dikend, ne mundemi si komitet mi dergu shkres për mi pa se cilat projekte janë realizuar, ne jemi të interesuar të bashkpunojm si komitet.

Pika e tretë: Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;

Për këtë pikë ja dha fjalën shefes së ZKKK Jasmina Denic.

Jasmina Denic pasi përshendeti të pranishmit tha: unë do të paraqes raportin mujorë në kuader të zyres tonë, tju kujtoj se në mbledhjen e kaluar e kemi biseduar projektin e IOM-it për rregullimin e parkut në shtepin e kultures në Zebinc dhe Pasjak, ky projekt është aprovuar në komisionin tonë

komunal dhe është dorzuar në IOM dhe besoj që gjatë javës së ardhshme do të realizohen këto projekte. Atë që e kemi thënë gjatë diskutimeve me IOM-in mirëpo edhe ne që e kemi në plan të punës është që panelet djellore të montohen në shkolla, në mënyrë që ta rrisim efikasitetin elektrike, ta zvogëlojmë fakturën e shpenzimeve të energjis elektrike. IOM do ta hulumtoj këtë fushë dhe do ta shohë mundësinë se si ti ndihmojmë këto shkolla. Kemi biseduar edhe me organizatën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ju kemi kërkuar që të na siguroj disa pako për vit t'ri dhe po presim që të aprovohet deri në fund të vitit. Kemi punuar edhe në planin aksional për riatdhesim të cilin sot do ta prezantoj. Ajo që është e rëndësishme tju informoj se këshilli danez për të zhvendosurit në kuader të projektit ka edhe një projekt për rregullimin e infrastruktures dhe ka kërkuar nga zyrja jonë një listë prej 5 projekteve që janë më të rëndësishme për Komunën tonë, ne i kemi dhënë propozimet, kjo listë është formuar në kuader të departamenteve tjera të Komunës dhe zyres së Kryetarit, është rregullimi i shtepisë së kultures në fshatin Koretishtë, nuk ka mjete pune në atë shtëpi për funksionim normal, me pastaj plotësimin e fondeve në bibliotekat e Komunës së Novobërdës me libra të rinjë në të dy gjuhët duke pasur parasysh që në bazë të informatave që kemi marrë nga Drejtoria e arsimit fondi i librave është shumë i vogël i kufizuar, propozimi tjetër është sigurimi i mjeteve për mbajtjen e panairëve të ndryshme në fushën e buqësisë, ne si Komunë jemi të vetmit që nuk kemi mjete për ta mbajtur një panair të tillë, propozimi tjetër është rregullimi i hapsirave publike. Në mbledhjen e kaluar ju kujtohet se kolegu juaj e ka propozuar që të funksionalizohet shtëpia e kultures në fshatin Koretishtë dhe atë e kemi futur, ju lutem që për të ardhmen të mendoni se çka është interesante dhe e nevojshme të bëhet dhe që mundë të realizohet ta propozoni. Antari i komitetit që ka pyetur rreth ambulantave shëndetsore tju pergjigjem rreth pyetjes që tju sigurojmë ambulantave oksigjen dhe paisje tjera për punë i kam pyetur më kanë thënë se kjo mundë të realizohet vetëm përmes Drejtorisë së Shëndetësisë. Gjithashtu kemi pasur takime të shumta me UNHACER rreth projektit për zgjedhje afatgjate duke pasur parasysh kërkesat e Komunës sonë një projekt për kthimin e cili është aktual nuk është i mjaftueshëm pra duhet të vaxhdojmë të gjejmë donator që në të ardhmen të jenë në gjendje të na ndihmojnë, kaq nga unë nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: e kam një pyetje për sallen në Llabjan që është jashtë funksionit a ka mundësi me u futur si projekt?, këtë sallë e kanë shfrytëzuar të dy komunitetet.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: ne në fshatin Stanishor jemi më të rrezikuarit dhe më të anashkaluarit se sa shtëpia e kultures në Koretishtë dhe fusha në Zebinc, ju çdo ditë kaloni aty dhe e dini gjendjen në Stanishor, nese keni prioritet të pastrohet oborri në Zebinc e të mos pastrohet oborri i shkolles në Stanishor atëherë vazhdoni.

Jasmina Denic tha: mirë që e ngritet këtë qështje por deklarojmë se si ZKK mirëpo me qështje konkrete, po ju permendi një rast se para katër viteve në Stanishor qendra e rinis kanë kërkuar që të rregullohet fusha e sportit dhe kanë kërkuar më projekt konkret për një afat të shkurtër ajo fushë është rregulluar do të thotë duhet të ketë nga Stanishori projekte konkrete.

Dobrivoje Djordjevic tha: që projekti konkret po më intereson më pastru plehi i derrave i lopeve që gjendet në Stanishor afër rrugës dhe Lumit.

Jasmina Denic tha: a jeni duke biseduar për realizim të një projekti për mbrojtje të ambientit?

Dobrivoje Djordjevic tha: po.

Pika e katërt: Propozim plani Komunal për ri integrimin e qendrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022;

Për këtë fjalë Kryesuesja ja dha fjalën Jasmina Denic.

Jasmina Denic tha: materialin për këtë pikë e kemi marrë të gjithë dhe e kemi marrë në të dy gjuhët, në këtë plan ka punuar më shumë kolegu Samia por ai nuk ka pasur mundësi që të vij sot ta prezantoj andaj do të mundohem unë tju prezantoj shkurtimisht, mos ta flas shumë rreth planit aksional por më

shumë rreth riatdhesimit, është obligimi yni ligjor që ta aprovojmë këtë planë. Ajo që bëhet fjalë në këtë planë është për personat e kthyer nga vendet e treta, bëhet fjalë për të gjithë qytetarët e Komunës së Novobërdës që kanë dalë jashtë shtetit e me pastaj i kanë kthyer e ata i kanë disa të drejta e këto të drejta janë të garantuara me ligj dhe ne si zyre e kemi për obligim që të pregadisim një planë për këta persona të riatdhesuar.

Kryesuesja tha: a pajtoheni që ta perkrahmi këtë pikë që të shkoj më tutje?.

Të gjithë antarët e pranishmëm të Komitetit e perkrahen këtë pikë.

Pika e pestë: Propozim plani Akcional për të zhvendosur dhe Kthim të qëndrueshëm;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Jasmina Denic.

Jasmina Denic tha: kerkoj mirëkuptim pasi që materialin e keni marrë vetëm në gjuhën serbe por e dini rastin si ka qenë po besoj se do ta keni edhe në gjuhën shqipe në KPF-e dhe Kuvend. Është gati se i njeti plan sikur i riatdhesimit dhe është obligim i zyres që ta kemi gjithashtu është i pregaditur në bazë të rregulloreve të cilat vlejn gati se në të gjitha Komunat, kerkoj nga ju si antarë të komiteteit të perkrahni edhe këtë plan, nese keni ndonjë pyetje do të mundohem tju pergjigjem, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: a pajtoheni që ta perkrahmi këtë pikë që të shkoj më tutje?.

Të gjithë antarët e pranishmëm të Komitetit e perkrahen këtë pikë.

Pika e gjashtë: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kam një propozim pasi që nuk është në rregull të vin antarët e komitetit të nënshkruhen dhe të dalin menjëher e kjo po perseritet nuk është mirë që të ndodhë kjo më.


Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: ata që vin nënshkruhen dhe dalin nuk mundë ta largojmë këtë dukur por ata që nuk vin fare duhet tju hiqet meditja.

Kryesuesja tha: për mbledhjet tjera në list do të nënshkruhen në fund të mbledhjes.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

